



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 32

Tiranë – E premte, 24 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 22.2.2017	Për indeksimin e pensioneve..... 2049
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 6, datë 9.2.2017	Për shpalljen e thirrjes së parë, për financimin e projekteve nga granti 2 “Arsimi”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2017..... 2051
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 7, datë 9.2.2017	Për shpalljen e thirrjes së parë, për financimin e projekteve nga granti 6 “Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2017..... 2055



VENDIM

Nr. 130, datë 22.2.2017

PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 61 e 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 24, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të nenit 6/1, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të nenit 1, të ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension”, të nenit 8, të ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar dhe të nenit 4, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksimin, në masën 3 për qind të:
 - a) pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr.4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuara;
 - b) pensioneve sociale, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;
 - ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;
 - d) shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - dh) shtesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 e 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24, të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;
 - e) pensioneve të caktuara dhe të rillojaritura me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji;
 - ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar;



f) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe palombarëve të Forcave Detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar,

gj) pensioneve të pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

h) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarje të industrisë ushtarake”;

i) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

j) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

k) shpërblimit të caktuar sipas ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar.

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet të cilat caktohen nga data 1.3.2017 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 28.2.2017, përfshirë edhe këtë datë.

3. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, që kanë datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.3.2016, nuk do të

jenë më pak se 13 014 (trembëdhjetë mijë e katërbëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 26 028 (njëzet e gjashtë mijë e njëzet e tetë) lekë në muaj.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, nuk do të jenë më pak se 8 912 (tetë mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) lekë në muaj, por jo më shumë se 13 014 (trembëdhjetë mijë e katërbëdhjetë) lekë në muaj.

5. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.3.2017 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 13 014 (trembëdhjetë mijë e katërbëdhjetë) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nr. 150/2014, të caktuara pas datës 1.3.2017, por me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, përveç pensionit, do të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr.763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit të pensioneve sipas pikës 1, të këtij vendimi, të jetë:

a) deri në 14 664 (katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe përfituesit e pensioneve sipas ligjit nr. 150/2014;

b) deri në 14 164 (katërbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 9 602 (nëntë mijë e gjashtëqind e dy) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë



11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, do t’i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi nga 1.3.2017 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 14 664 (katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj.

8. Përfituesit e pensioneve, sipas shkronjave “a”, “e” dhe “gj”, të pikës 1, të këtij vendimi, krahas pensionit dhe kompensimeve, sipas përcaktimeve në pikat 6 dhe 7, të këtij vendimi, do të marrin edhe kompensimet sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet nr. 138, datë 31.3.1994, Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”; nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajurit dhe gazit të lëngshëm”.

Pas datës 1.3.2017, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të qytetit me datë fillimi deri në 31.12.2014, shtuar me kompensimet, nuk mund të jenë më të vogla se 15 164 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, të ardhurat maksimale arrijnë 26 528 (njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë në muaj, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të fshatit nuk mund të jenë më të vogla se 9 802 (nëntë mijë e tetëqind e dy) lekë në muaj, ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e parakohshme, shtuar me kompensimet, nuk mund të jenë më të vogla se 15 164 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përlogariten në shumën 2 600 000 000 (dy miliardë e gjashtëqind milionë) lekë, dhe përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 2017 dhe ndahen përkatësisht:

a) 2 574 500 000 (dy miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër milionë e pesëqind mijë) lekë, për mbulimin e pagesave të pensioneve;

b) 25 500 000 (njëzet e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për nxjerrjen e udhëzimit teknik në/dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, dhe i fillon efektet financiare nga data 1.3.2017.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 6, datë 9.2.2017

PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË PARË, PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE NGA GRANTI 2 “ARSIMI”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2017

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr.130 datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve të reja nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2017, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1 Granti 2 “Arsimi” (a. granti për arsimin bazë; b. granti për arsimin e mesëm), “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I”.

1.2 Drejtimit e thirrjes për financim janë:

a) rehabilitimi i objekteve arsimore ekzistuese në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm, të cilat e rrisin aksesin në arsim dhe/ose janë në rrezik shembjeje apo kanë nevojë emergjente për ndërhyrje dhe rijetësimi i terreneve sportive të shkollave.



2. Për drejtimin sipas shkronjës “a”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, vlera e financimit të thirrjes së parë, për vitin 2017 është 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë.

3. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara kryhet nga sekretariati teknik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet ministri i Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

SHTOJÇË I

KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes së grantit, programit dhe shtyllës së financimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
12 ditë kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare	Aplikuesit sipas pikës 3, të këtij vendimi	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi <i>online</i> në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi online për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit. Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve (në Kryeministri), <u>nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por ato dorëzohen vetëm pranë sekretariatit teknik në ministri.</u>
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas shtojcës III të këtij vendimi.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim, si dhe projekt-vendimin që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
3 ditë pune nga dërgimi i propozimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik, koordinon dhe organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.



SHTOJCË II FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë Sekretariatit Teknik.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”).
Nënprogrami i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 130 /2016, “Për buxhetin e vitit 2017”).
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve të projektit, për të qartësuar shtrirjen kohore të tij.
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: <ul style="list-style-type: none"> - Vendndodhja e objektit të investimit; specifikuar në hartë ku është sqaruar qartë kufiri i ndërhyrjes; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i detajuar i punimeve/ndërhyrjeve që do të kryhen; - Grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve; - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; - Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse aplikohet), si edhe dokumentacioni përkatës (hartat përkatëse kadastrale etj).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.
Sipërfaqe e trajtuar (*)	Të specifikohet sa është sipërfaqja e përgjithshme në të cilën ndërhyrja projektit dhe nëse zhvillohet me faza apo lote.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtën program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje /lidhjes me drejtimet e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: <ul style="list-style-type: none"> - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj; - Të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit (në çdo rast, vlera të jetë me TVSH).
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore (*)	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore apo nga donatorë.
Financim nga donatorë (*)	Nëse ka financim nga donatorë, të jepet vlera e donacionit në monedhën lekë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi, të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.



Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja totale e projektit të jepet me TVSH.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	<input type="checkbox"/> Po / <input type="checkbox"/> Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale)	<input type="checkbox"/> Po / <input type="checkbox"/> Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Deklarime (*)	Aplikanti deklaron se: i. Projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve. ii. Projekti është në listën e projekteve/nejave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe/ose të prioriteteve. iii. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar për pajisjen me të gjitha lejetimet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iv. Janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përllogaritjen e kostos dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse dosja e aplikimit përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit; - preventivin; - grafikun e prokurimit dhe grafikun e zbatimit të punimeve; - relacionin teknik; - specifikimet teknike; - CD; - përllogaritjet/parashikimin e kostove të mirëmbajtjes së investimit.
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendndodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, WGS 84 UTM 34 N
Foto – gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin jpeg ose pdf
Pamje 3-dimensionale (*) i detyrueshem	Imazhe në formatin jpeg ose pdf

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM. Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

a) aplikimi *online* në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi *online* për FZHR-në (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.)

ose

b) me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit.

2. Formatin e aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni/subjekti aplikues.

3. Dokumentacioni teknik i dorëzuar duhet të jetë detyrimisht i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.



SHTOJCA III
KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR FINANCIM
(Shtylla I, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, granti “Arsimi”)

Këto kritere përdoren nga sekretariati teknik për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 100 pikë**, i një projekti që propozohet për financim/miratim nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Kriteret detajohen në nënkriteret përkatëse, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”.

Kriteret e domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt, i përcakton sekretariati teknik.

Kriteret për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e ndikimit në arritjen e objektivave të politikës dhe impakti në realizimin e masave, sipas drejtimeve të thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve: ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 20 pikë.

2. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë me grafik punimesh të detajuar, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar e vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen si koherente për financim: ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 25 pikë

3. Ndikimi i projekteve dhe avantazhet në lehtësimin e aksesit në shërbimet arsimore, ndërveprimet midis zonave urbane e rurale duke rritur mbulimin në shërbime, zgjidhjen e nevojës emergjente për ndërhyrje, përmirësimin të cilësisë së shërbimit dhe jetës komunitare dhe më gjerë, zhvillimin ekonomik-social, parë nga ana e përfituesit, qytetarit: ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 25 pikë.

4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike: ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë (nxënës/mësues/komunitet) nga projekti ose zona kryesore dhe dytësore e ndikimit/mbulimit të shërbimit prej tij. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë: ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve: ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

VENDIM
Nr. 7, datë 9.2.2017

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË PARË,
PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE
NGA GRANTI 6 “REHABILITIM
MJEDISOR, GJELBËRIM DHE
PYLLËZIM”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT
TË INFRASTRUKTURËS VENDORE
DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PJESË E
FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr.130 datë 15.12.2016 , “Për buxhetin e vitit 2017”, me

propozimin e Ministrisë së Mjedisit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve të reja nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2017, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1 Granti 6: “Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I”.

1.2 Drejtimet e thirrjes për financim janë për:
a) projekte që kontribuojnë në rehabilitimin mjedisor, nëpërmjet gjelbërimit dhe pyllëzimit të



zonave të degraduara në afërsi të qyteteve, si dhe në qytete e fshatra.

2. Për drejtimin sipas shkronjës “a”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, vlera e financimit të thirrjes së parë, për vitin 2017 është 99 000 000 (nëntëdhjetë e nëntë milionë) lekë.

3. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në shkronjën “a”, pika 1.2, të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara kryhet nga sekretariati teknik, në Ministrinë e Mjedisit, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet ministri i Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI

Niko Peleshi

SHTOJCË I

KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes së grantit, programit dhe shtyllës së financimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
12 ditë kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare	Aplikuesit sipas pikës 3, të këtij vendimi	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi <i>online</i> në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi <i>online</i> për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 . ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Mjedisit. Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, <u>nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por ato dorëzohen vetëm pranë sekretariatit teknik në ministri.</u>
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas shtojcës III të këtij vendimi.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim, si dhe projekt-vendimin që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
3 ditë pune nga dërgimi i aplikimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik, koordinon dhe organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Zëvendëskryeministri

Ministri i Financave

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,

Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ministri i Zhvillimit Urban

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

Ministri i Arsimit dhe Sportit

Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe

Administrimit të Ujërave

Ministri i Shëndetësisë

Ministri i Kulturës

Ministri i Mjedisit

Ministri i Punëve të Brendshme

Ministri i Shtetit për Inovacionin

dhe Administratën Publike

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë

Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1

Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar;

anëtar;

anëtar

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar.



SHTOJCË II
FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë Sekretariatit Teknik.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet (sipas aneksit 3 të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”).
Nënprogrami i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet (sipas aneksit 3 të ligjit nr. 130 /2016, “Për buxhetin e vitit 2017”).
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve të projektit, për të qartësuar shtrirjen kohore të projektit.
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; specifikuar në hartë ku është sqaruar qartë kufiri i ndërhyrjes; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistuese (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i detajuar i punimeve/ndërhyrjeve që do të kryhen; - Grafikon e punimeve; - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; - Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës, si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj.).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë dhe i bizneseve që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.
Sipërfaqe e trajtuar (*)	Të specifikohet sa është sipërfaqja e përgjithshme në të cilën ndërhyr projekt.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/ nevojës për ndërhyrje /lidhjes me drejtimet e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit (ose kosto të tjera), pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohet të jenë këto kosto, si do të sigurohen etj. - Të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston total të projektit (në çdo rast vlera të jetë me TVSH).
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore (*)	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore apo nga donatorë.
Financim nga donatorë (*)	Nëse ka financim nga donatorë, të jepet vlera e donacionit në monedhën lekë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi, të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.



Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja totale e projektit të jepet me TVSH.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale).	<input type="checkbox"/> Po / <input type="checkbox"/> Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale).	<input type="checkbox"/> Po / <input type="checkbox"/> Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Deklarime (*)	Aplikanti deklaron se: i. Projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve. ii. Projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe/ose të prioriteteve. iii. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar për pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iv. Janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përllogaritjen e koston dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse dosja e aplikimit përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit; - preventivin; - relacionin teknik; - specifikimet teknike; - grafikun e prokurimit dhe grafikun e zbatimit të projektit; - CD; -përllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit (ose kosto të tjera).
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendndodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, WGS 84 UTM 34 N.
Foto – Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin jpeg ose pdf
Pamje 3-dimensionale (*) i detyrueshëm	Imazhe në formatin jpeg ose pdf

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM. Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

a) aplikimi *online* në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi *online* për FZHR-në (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.)

ose

b) me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Mjedisit.

2. Formatin e aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni/subjekti aplikues.

3. Dokumentacioni teknik i dorëzuar duhet të jetë detyrimisht i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.



SHTOJCA III
KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR FINANCIM
(Shtylla I, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal,
granti “Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”)

Këto kritere përdoren nga sekretariati teknik për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 100 pikë** i një projekti që propozohet për financim/miratim nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Kriteret detajohen në nënkriteret përkatëse, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Mjedisit, sipas aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”.

Kriteret/kërkesat e domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt, i përcakton sekretariati teknik.

Kriteret për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e ndikimit në arritjen e objektivave të politikës dhe impakti në realizimin e masave, sipas drejtimeve të thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.

2. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë me grafik punimesh të detajuar, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar e vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen si koherente për financim: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.

3. Ndikimi i projekteve dhe avantazhet në promovimin e potencialeve të qyteteve, tipareve natyrore dhe mjedisore, si dhe ndërveprimet midis zonave urbane e rurale, përmirësimin të qendrave, shërbimeve urbane dhe jetës komunitare, shëndetit publik, rehabilitimit mjedisor për zhvillim të qëndrueshëm, parë nga ana e përfituesit, qytetarë dhe/ose biznes: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.

4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti ose zona kryesore dhe dytësore e ndikimit prej tij. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve /përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 112 lekë